



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:293829

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747186

KPPP.nr. 2230/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit PROGLOBAL Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. "28 Nëntori", lok. 3/1, kundër debitorit "Trepça" Sh.A., me seli në Mitrovicë, Parku Industrial, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 327/23 i datës 07.12.2023, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Eset Murati nga Prishtina, jashtë seancës me datën 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit "Trepça" Sh.A., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 327/23 i datës 07.12.2023, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Eset Murati, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit PROGLOBAL Sh.P.K., me datë 07.12.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 327/23, duke lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 02/2023, e datës 13.01.2023; Faturës nr. 06/2023, e datës 30.01.2023 dhe Faturës nr. 110/2023, e datës 17.10.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e pranimit të urdhrin t'ia paguajë kreditorit shumën prej 5,892.10 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e rënies në vonesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbareimor, me arsyetimin se dokumentet në bazë të së cilave është marr vendimi përmbareues ose urdhri përmbareues, nuk janë dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar, ashtu që nuk janë

të përshtatshme për përmbardim, duke mos u plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 38 dhe nenit 40 të LPP-së. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të anulojë urdhrin përmbardimor.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim janë të pa bazuara për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbardimor janë në origjinal, si dhe janë pranuar dhe protokolluar nga debitori, duke mos bërë denoncimin e të njëjtave. Ka shtuar se debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur me prova siç përcaktohet me nenin 69.4 të LPP-së, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbardimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se fatura nr. 02/202, e datës 13.01.2023; fatura nr. 06/2023 e datës 30.01.2023 dhe fatura nr. 110/2023 e datës 17.10.2023, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur

propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të ngritura nga prapësim por që nga vlerësimi i tyre erdhi në përfundim se ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2230/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.